



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Primaire / Primarja / Nr. Dato			
Nr. Urtiparim / Ord. Broj	Primaire / Primarja	Subjekt / Predmet	Vlera / Vrednost
	060/01-		125



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e II të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën 27.02.2025 (e Enjte), duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Kuvendit Komunal,
2. Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-dhjetor 2024.
3. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2024.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Viti, më 19.02.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Belkëm Azizi






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 30.01.2025 (e enjte) në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit, si: z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, Marigona Avdiu, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Musli Neziri, z. Veton Ramadani, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete Rama, znj.Anisë Zejnullahu, ndërsa mungoi z.Durim Sylejmani, z.Reshat Azizi, z.Taulant Haxhiu, z.Sokol Shaqiri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike, dhe të tjerë. Pasi u konstatua se prezent janë 23 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë për këtë vit të Kuvendit. Gjatë kësaj periudhe konfirmimin e ligjshmërisë na e ka kthyer prapë Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba, ndërsa tek aktet tjera nga seanca e kalimeve jemi në rregull. Unë para se me hi në rend dite du me ju falenderu të gjithëve. E di që jemi në fushatë zgjedhore, ju falenderoj të gjithëve për një angazhim për paraqitjen e programeve për fushatën që po bëhet në komunën tonë. Është një fushatë e mirë, e qetë, ju falenderoj për këtë dhe shpresoj që deri në ditën e zgjedhjeve të shkon kështu. Me qenëse jemi në fund të fushatës, ju kisha kërku që të përmbahemi në pyetjet e përgjigjet.

z.Jakup Demiri: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë si shef i grupit të LVV-së, në emër të grupit nuk do të parashtoj pyetje, sepse jemi në një gjendje kohë fushate, e nuk besoj që e ka efektin. Pyetjet do t'i lëmë për seancën e radhës. Uroj që të shkon kjo fushatë mbarë e mirë.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në koordinim me grupin e këshilltarëve të LDK-së, për shkak të fushatës, që në emër të grupit dhe në emër të grupit të përgëzoj për një fushatë të qetë dhe shumë përmbajtësore të nivelit të Komunës së Vitisë, ne në këtë seancë të gjithë grupi nuk do të kemi pyetje para se me hy në rend të ditës.

z.Musli Neziri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe ne ju bashkëngjitemi grupeve tjera parlamentare këtu në kuvend, dhe nuk do të kemi pyetje jashtë rendit të ditës. Uroj një fushatë të mirë, të mbarë dhe të jemi shembull për komunat tjera.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Mirëpo, pasi që drejtori i shërbimeve publike nuk është këtu tash, po e bëjë kërkesën të cilën e kam nga banorët e dy lagjeve të fshatit Tërstenik, lagjia "Grome" dhe "Muhagjert". Që një kohë të gjatë këtu është blloku kanalizimi, tash mbeturinat e këtij kanalizimi kanë dalë mbi sipërfaqe të tokës, banorët e këtyre lagjeve e kanë lajmru "Hidro Moravën" e cila është menaxhuere e këtij kanalizimi, mirëpo deri tash pa sukses. Kërkesa im është. Nënkryetar, në bazë të kompetencave të cilat i keni, mundësisht të intervenoni e të zgjidhet ky problem.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Fillimisht ju përgëzoj për propozimin e dhanë, edhe i përgëzoj shëfat e grupeve për mirëkuptimin që e patën për shkak të gjendjes, që jemi në gjendje të fushatës. Edhe unë i

bashkëngjitem atij urimi, dhe më banë krenar gjithëherë që jam vitias, për shkak se kultura e polarizmi politik, Vitia e ka tregu që pas luftës mënjëherë ndoshta u kanë shembull në nivel të republikës sonë, për një fushatë që me të vërtet, e kësaj radhe ndoshta është edhe me e avancume edhe në aspekt organizativ, po edhe në aspekt të fjalorit, edhe të gjitha tipareve që i përngjanë një fushate me të vërtet të moderume dhe të qytetruar, dhe i përgëzoj kryetarët e subjekteve politike dhe kandidatet të cilët garojnë, ju uroj secilit suksese dhe uroj që kjo formë të mbyllet deri me datën 9 shkurt dhe të jet ditë manifestimi, pavarësisht të rezultatit. Kërkojmë edhe nga subjektet politike që të punojnë me komisionerët e tyre që, edhe këtu të dalim faqebardhë dhe të sakt. Sa i përket kërkesës së Nexhatit, janë disa çështje që ndodhin e nuk na vesin. Pyetja është plotësisht me vend. Unë e kam numrin tanë të telefonit, pas seancës do të mirrem shumë me seriozitet dhe besoj që brenda ditës apo nesër do të informoj si është gjendja, sepse nuk po e di a kemi kompani të kontraktume që shkon. Po do ta shoh gjendjen si është.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Për këtë seancë materialin e keni marrë me kohë. Për këtë mbledhje kemi këtë:

R e n d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2025.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësim ndryshimin e Vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronat e paluajtshme për vitin 2025.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit paraprak me nr. 01-035/02-1358, të datës 29.11.2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit**
5. **Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën janar - dhjetor 2024.**
6. **Informatë mbi punën e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë për periudhën janar - dhjetor 2024.**
7. **Informatë për zbatimin e planit të KKS-së për vitin 2024.**

Kemi edhe një kërkesë për pikë shtesë të rendit të ditës, **propozim për ndryshim plotësim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba**

z.Visar Demiri, drejtor i Urbanizmit bënë prezentimi e pikës shtesë të rendit të ditës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka najkush tjetër rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka: a jeni që të miratohet rendit i ditës me pikën shtesë, Propozim për ndryshim plotësim të rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba? Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Kuvendit Komunal**

Nga të gjithë të pranishmit u miratu pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë e rendit të ditës kemi:

2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2025.**

Kryesuesi, z.Bekim Aziz: Ne e kemi miratu këtë çdo vit, po duhet edhe këtë vit me e miratu orarin e mbajtjes së takimeve. Materialin e keni marr me kohë: a keni ndonjë vërejtje?

z.Nexhat Halili: Tek muaji nëntor po e shoh një gabim, takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa me datën 29.11.2025, kurse takimi i kuvendit me 28.11.2025. A është ndonjë gabim teknik.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përmirësohet ky gabim teknik. A jeni me këtë gabim teknik të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësim ndryshim e Vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronat e paluajtshme për vitin 2025

Këtu kemi të bëjmë me një ndryshim plotësim tek preambula e vendimit. E kemi materialin, hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka debat e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit paraprak me nr. 01-035/02-1358, të datës 29.11.2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Nëse ju kujohet, në seancën e muajit të nëntorit kemi caktu një lokacion për dhënien në shfrytëzim të paneleve solare dhe vetëm u kërku që të definohet forma si duhet të jepet. Materialin e kemi marr me kohë, hapi debat për këtë pikë.

z.Jakup Demiri: Edhe kur u miratu vendimi bazë, ne kemi abstenu për disa arsye që nuk po du tanë me i cekë. Prapë ne si grup abstenojmë tek kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi z.Bekim Aziz: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qes në votim për miratim. Me 16 vota pro, kundër nuk ka, abstenuim 7, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën janar - dhjetor 2024

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Informatën e kemi marrë me kohë, i kemi të dhënat në informatë, hapi debat për diskutim për këtë pik të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, kjo pikë nuk votohet. Kalojmë në pikën tjetër.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Informatë mbi punën e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë për periudhën janar - dhjetor 2024

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Edhe këtë informatë e kemi marr me kohë. Hapi debat edhe për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, kjo pikë nuk votohet, kalojmë në pikën tjetër.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Informatë për zbatimin e planit të KKS-së për vitin 2024

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Para juve e kemi informatën lidhur me zbatimin e planit të KKS-së. Është hera e parë pas shumë viteve që KKS ka mbajti 4 takime nga 6 të cilët i ka obligative. Ka qenë për shkak të pakënaqësisë të cilën e kanë anëtarët e KKS-së rreth pagesës, që unë konsideroj të arsyshme, sepse në udhëzim thotë që, mëditja e tyre do të jet si mëditja e anëtarëve të KPF-së, mirëpo me Ligjin e Pagave këta nuk po kanë mëditje, e nga kjo edhe nuk po mbahet takimet e KKS-së. Po duhet me i falenderu qytetarët e Komunës së Vitisë, sepse gjendjen e sigurisë e kemi të mirë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Propozim për ndryshim plotësim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha

Kryesuesi, z.Bekim Aziz: Hapi debat për këtë pikë siç e prezentoj drejtori Visari. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës me ndryshime siç e ka kërku ministria. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Faleminderit të gjithëve, shihemi në seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:40 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar-Pranimes Me Datas 20-02-2025

Nr. Komunitet Qyt. Hox	Nr. Komunitet Hox	Nr. Komunitet Hox	Vlera Vendimit
02-	052/	02-	130



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

***Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën
janar – dhjetor 2024***

Viti, shkurt 2025

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

Përmbledhje

- Hyrje 3

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

- Njësia për Auditim të Brendshëm 4
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore 4
- Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete 6
- Zyra për Barazi Gjinore 7
- Zyra për Prokurim 8
- Avokati Publik i Komunës 9
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun 10
- Zyra për Integritet Europian 11

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

- Drejtoria e Administratës 12
- Drejtoria e Inspeksionit 16
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë 19
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 22
- Drejtoria për Arsim 36
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit 43
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 46
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi 53
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport 54
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim 56

KAPITULLI I

Përmbledhje

Raporti për vitin 2024 i Kryetarit të Komunës së Vitisë dhe organeve komunale përmban një analizë të detajuar të aktiviteteve, arritjeve dhe sfidave të përballuara gjatë periudhës së raportimit. Ky raport pasqyron përpjekjet dhe rezultatet e arritura në fusha kryesore të zhvillimit ekonomik, infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale si dhe kulturës dhe sportit. Ai përfshinë gjithashtu rekomandime dhe plane për përmirësimet e ardhshme, bazuar në analizën e të dhënave dhe adresimet e qytetarëve dhe grupet tjera të interesit.

Hyrje

Të nderuar Këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Vitisë, gëzohem që kam mundësinë të jem sot para jush për të prezantuar raportin e aktiviteteve dhe realizimeve të Komunës së Vitisë për vitin 2024.

Ky është një moment i rëndësishëm, ku kemi mundësinë të vlerësojmë punën që është bërë gjatë këtij viti dhe të diskutojmë së bashku mbi sfidat dhe mundësitë për të ardhmen. Si kryetar i Komunës, është detyra ime të siguroj që çdo vendim, çdo projekt dhe çdo iniciativë që realizohet të jetë në shërbim të qytetarëve dhe interesave të tyre. Gjatë vitit 2024 kemi punuar pa u ndalur për të përmirësuar kushte më të mira jetese, për të zhvilluar infrastrukturën dhe për të ofruar shërbime më cilësore në çdo fushë. Ky raport që do të prezantojmë sot është një pasqyrë e angazhimit tonë dhe një mundësi për të pasur një diskutim të hapur mbi atë çfarë kemi arritur dhe çfarë mbetet për t'u bërë.

Në këtë raport do të paraqesim aktivitetet kryesore dhe projektet që janë realizuar gjatë vitit 2024. Kjo përfshinë ndihmën dhe mbështetjen për zhvillimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e shërbimeve publike, investimet në arsim dhe shëndetësi, si dhe nismat për zhvillimin ekonomik dhe mbështetje për bizneset vendorë. Gjithashtu do të flasim për sfidat që kemi hasur gjatë këtij viti, duke përfshirë faktorët ekonomik, menaxhimin e burimeve dhe përpjekjet për të përballuar kërkesat gjithnjë në rritje të qytetarëve. Por, ky raport nuk është vetëm një pasqyrë e arritjeve, por një mundësi për të dëgjuar mendimet dhe sugjerimet tuaja, qytetarë të nderuar. Bashkëpunimi dhe transparenca janë thelbësore për një qeverisje të suksesshme. Angazhimi im ka qenë gjithmonë që të jem i hapur për të dëgjuar, për të adresuar shqetësimet dhe për të bashkëpunuar me çdo qytetar, sepse vetëm kështu mund të krijojmë një komunë më të mirë për të gjithë.

Vizioni ynë për vitet në vazhdim është i qartë: vazhdimi i zhvillimit të qëndrueshëm, krijimi i mundësive për rininë, përmirësimi i kushteve për bizneset, dhe ruajtja e një ambienti të pastër dhe të shëndetshëm për banorët tanë. Ky raport është një hap tjetër në këtë drejtim, dhe unë jam i bindur që, me mbështetjen e juaj do të arrijmë shumë më tepër.

KAPITULLI II

Raporti i Zyrave të Kryetarit

Njësia për Auditim të Brendshëm (NJAB)

Njësia për Auditim të Brendshëm gjatë vitit 2024 ka pas të planifikuar 2 auditime dhe ka realizuar gjithashtu 2 auditime.

Auditimet e kryera gjatë kësaj periudhe janë:

1. Emërtimi I Auditimit
Auditimi Nr.DSHS – 01
Tema: Menaxhimi I kontratave Kapitale për vitin 2023
2. Emërtimi I Auditimit
Auditimi Nr. DSHS-02
Tema: Të hyrat nga tatami në pronë për vitin 2023

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Për vitin 2024, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me kryetarin e Komunës ka hartuar planin e personelit në bazë të udhëzimeve (UA) të cilat janë dhënë nga Ministria për Administratë Publike - Departamenti i Shërbimit Civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Mbështetur në këtë kemi klasifikuar këto aktivitete:

Konkurset dhe zhvillimi i procedurave të konkursit: NjMBNj në pajtim me ligjin dhe aktet normative ka zhvilluar procedurat e konkurseve të jashtme, ngritje në detyrë apo lëvizje paralele. Të gjitha procedurat e konkurseve janë zhvilluar falë bashkëpunimit me drejtoritë përkatëse të Komunës së Vitisë, përkatësisht zyrtarëve të drejtorive përkatëse si dhe falë bashkëpunimit të komisionëve rekrutuese, të cilët kanë qenë të pavarur në punë dhe ju kemi ofruar ndihmë profesionale juridike-teknike. Mbështetur në këtë, paraqesim aktivitetet e rekrutimit apo pranimit në punë të punëtorëve na pajtim me planin e punës, duke i radhitur aktivitetet sipas drejtorive komunale:

Drejtoria për Administratë: Për pozitën asistent administrativ të shpallur më 16.04.2024 kanë aplikuar 30 kandidatë, është pranuar vetëm njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë); për pozitën roje objekti të shpallur më 19.04.2024, kane aplikuar tre (3) kandidatë dhe është pranuar vetëm njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë); për pozitën zyrtar për gjendje civile i shpallur më datë: 08.11.2024 kanë aplikuar 29 kandidatë dhe është pranuar vetëm njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Drejtoria për Inspektion: Për pozitën inspektion i komunikacionit të shpallur më datë 03.05.2024 kanë aplikuar dymbëdhjetë (12) kandidatë, ndërsa është pranuar vetëm njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë); për pozitën zyrtar për menaxhim financiar dhe kontroll (marrëdhënie kontraktuale) të shpallur me datë 20.06.2024 kanë aplikuar katër (4) kandidatë dhe është pranuar vetëm njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë: Për pozitën zyrtar ligjor (marrëdhënie kontraktuale) të shpallur më 22.03.2024 kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriterët e konkursit kanë qenë tre (3) kandidatë dhe është pranuar vetëm njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Drejtoria për Arsim: Duke u mbështetur në Ligjin për Zyrtar Publik si dhe duke u mbështetur në kërkesat e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti, NjMBNj ka shpallur konkurse dhe ka rekrutuar personelin arsimor, brenda periudhës janar - dhjetor 2024, duke realizuar 39 pozita me sukses (pranim), numër në të cilin përfshihen edhe zëvendësimet. Nga të dhënat që posedojmë, në këto konkurse kanë konkurruar 125 kandidatë, duke përfshirë personel udhëheqës (drejtorë shkollash), personel mësimdhënës (professor/eshë lëndor, mësimdhës lëndor 6-9, mësimdhënës klasor 1-5, edukator/e), staf mbështetës (punëtor teknik). Pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitat e kërkuara në konkurs janë pranuar në punë 39 persona, duke përfshirë edhe zëvendësimet, në mesin e tyre edhe katër (4) punëtor teknik, ndërsa pasi kemi bërë shpalljen e konkurseve për nëpunës teknik dhe mbështetës të datës 19.12.2024, kryetari i Komunës së Vitisë ka nxjerr vendim për anulimin e tyre (shih njoftimet zyrtare).

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – QKMF, në konkursin doktor i mjekësisë në QKMF kanë aplikuar pesë (5) kandidatë, ndërsa është pranuar njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë). Për tre (3) pozitat doktor i mjekësisë familjare në QKMF të shpallur me datë 22.11.2024, dy ditë para mbylljes së konkursit, kryetari i komunës me datë 20.12.2024 nxjerr vendim për anulimin e tyre. Për pozitën punëtor Teknik-QKMF kanë aplikuar gjashtë kandidatë dhe është pranuar vetëm njëri prej tyre ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Drejtoria për Financa: Në Drejtorinë për Financa, në konkursin për Zyrtar për Zhvillim kanë aplikuar 9 kandidatë, ndërsa është pranuar vetëm njëri prej tyre ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë). Në Sektorin e Tatimit në Pronë për pozitën zyrtar i tatimit në pronë, të shpallur me datë 01.08.2024 kanë aplikuar 18 kandidatë dhe është pranuar vetëm njëri prej tyre ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë). Për pozitën Zyrtar Ligjor (Marrëdhënie Kontraktuale) të shpallur më 22.03.2024 kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriterët e konkursit kanë qenë tre (3) kandidatë dhe është pranuar vetëm njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Drejtoria për Urbanizem Planifikim dhe Mjedis: Zyrtar për çështje juridike (marrëdhënie kontraktuale) të shpallur me datë 29.04.2024, kanë aplikuar tre (3) kandidatë dhe është pranuar njëri prej tyre ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural: Për pozitën zyrtar për zhvillim rural të shpallur me 08.07.2024 kanë aplikuar nëntë (9) kandidatë dhe është pranuar njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport: Për pozitën bibliotekist të shpallur me datë 16.04.2024, kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit kanë qenë katër (4), ndërsa pas procedurave të rekrutimit vetëm njëri prej tyre është pranuar, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Njësia e Personelit: Për pozitën Auditor i Brendshëm i shpallur me datë 01.08.2024 kanë aplikuar dhjetë (10) kandidatë dhe është pranuar njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë). Për pozitën zyrtar i personelit i shpallur me datë 05.03.2024 kanë aplikuar 22 kandidatë, ndërsa është pranuar një (1) kandidatë, mirëpo ky konkurs i kësaj date është anuluar me vendim të KPMSHCK-së. Për pozitën zyrtar i personelit i rishpallur me datë 01.08.2024 kanë aplikuar 16 kandidatë, ndërsa është pranuar njëri prej tyre, ashtu siç është paraparë në konkursin publik (një pozitë).

Mjetet juridike dhe shqyrtimi i tyre: Duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, e drejta për shfrytëzim të mjeteve juridike në procedurë administrative është parim primar, prandaj mbështetur në këtë, gjatë fazës së rekrutimit si dhe punës së përditshme të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, palët në procedurë administrative kanë shfrytëzuar mjetet juridike. Mbështetur në kompetencë, këtyre mjeteve u janë përgjigjur komisionet e ankesave në afat ligjor:

- Komsioni për nëpunësit e shërbimit publik (Arsim dhe Shëndetësi) ka shqyrtuar 5 ankesa dhe të cilat janë refuzuara si të pabazuara, dhe vetem njera është në Procedurë Gjyqesore.
- Vendime të shkuarjes në pension dhe lirim nga shërbimi civil të 14 (katëmbëdhjetë) zyrtarve të shërbimit civil, përpiluar nga NJMBNJ-ja;
- Vendim për pushime pa pagesë për 1 vit, një (1) shërbyes civil.
- Pefundim I marrëdhënies së punës: Mehmet Drugzani me aktgjykim të formës së prerë
- Per shkak të pensionimit pesë (5) zyrtar.
- Nje rast tjetër për shkak të dorehëqjes, lirim nga Marrëdhënia punës
- Vendim për pushim pa pagesë për dy vite një (1) zyrtar.
- Ankesa kemi pasur të natyrave të ndryshme, si nga KMPSHCK ashtu edhe të natyrës lokale, të cilat janë shqyrtuar bazuar në ligj dhe rregullore përkatëse të natyrës së konkursit, ku disa nga to janë ende në procedurë verifikimi

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të gjithë kandidatëve ju ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike në procedurë të rekrutimit, ku udhëheqësi i saj, z.Hysen YMERI ka zbatuar në përpikmëri parimin e merites dhe mundësive të barabarta, profesionalizmin dhe integritetin, mosdiskriminimin dhe përfaqësimin e drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, detyrimin për respektim të Kushtetutes, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, detyrimin për transparencë dhe konfidencialitet. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe vendime, shkresa të ndryshme rutinë që janë natyrë e punës administrative dhe zyrtare.

Vlerësimi i performancës (rezultate në punë) së zyrtarëve publik: Në kordinim me drejtoritë përkatëse, për të gjithë zyrtarët publik është duke u bërë vlerësimi i rezultateve të punës konform rregullave dhe afateve ligjore që i parasheh L.ZP 08/L-197. Ky proces është duke u bërë duke respektuar rregullat, ku mbikëqyerësit e drejtpërdrejt janë duke vlerësuar rezultatet në punë të zyrtarëve të tyre, në kuadër të departamentit përkatës. Kurse NJMBNJ-ja në vazhdimësi ka monitoruar dhe do të sistemoj vlerësimet në dosjet e tyre personale ashtu siç parshihet në L.ZP. Gjatë vitit 2024 vëmendje i është kushtuar nevojave për trajnimin e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rinj. Në bashkëpunim me IKAP-in janë mundësuar trajnime për profilet përkatëse tek nëpunësit ekzistues dhe trajnimi hyrës për nëpunës të rinj. Dosjet Individuale elektronike për nëpunës të shërbimit publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës janë përpunuar gjatë vitit 2024, duke u ngarkuar dokumente relevante të secilit nëpunës, por edhe dosjet individuale elektronike për shërbimin civil janë përpunuar dhe plotësuar përgjatë këtij viti kalendarik. Njësia për Menaxhimin të Burimeve Njerëzore ka përpiluar Planin e Personelit për vitin 2024 përmes SIMBNJ/HRMIS. I njëjti është dërguar për aprovim tek udhëheqësi më i lartë administrativ për aprovim. Pas aprovimit të njejtin duhet dërguar në DMZP në Prishtinë. Ky raport është punuar në përputhje me nenin 16, paragrafi 4 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr.08/L-197.

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Gjatë periudhës kohore është bërë monitorimi dhe raportimi i ligjeve që janë në funksion të të drejtave të njeriut, janë orhanizuar takime me organizatat joqeveritare që punojnë në këtë fushë, janë mbajtur fushata ndërgjegjësimi me komunitetin e gjërë, duke përfshirë rininë shkollore e disa takime tjera për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Njësia e të Drejtave të Njeriut dhe Komuniteteve për vitin 2024 në bashkëpunim me kryetarin e komunës ka hartuar planin e punës në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria për Administratë Publike, Departamenti i Shërbimit Civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorin për Buxhet dhe Financa.

Njësia e të drejtave të njeriut dhe komunitete ka patur vazhdimisht kontakte me avokatin e popullit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në rajonin e Gjilanit, i cili vazhdimisht ka qenë prezent për kërkesat që janë

paraqitur për shqyrtim. Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë paraqitur 8 raste të cilat i ka shqyrtuar avokati i popullit dhe i ka rekomandur për të drejtat e tyre të cilat kanë menduar se u janë shkelur. Raste kemi patuar për të drejtat e njerit me personat me aftësi të kufizuar për punësim, pasi që ligji e precizon në bazë të numrit të punësuarve në institucionin tonë të ketë persona me aftësi të kufizuar. Kryetari ka marre iniciativën që të respektohet kuota e punësimit për këtë kategori ku edhe është vepruar. Përveç kësaj, ne si zyre kemi patur disa trajnime me organizata të huja lidhur me të drejtat e njeriut, siç janë OSBE-ja, grupi i grave për barazi gjinore. Temat të cilat janë debatuar nëpër trajnime të ndryshme kanë qenë higjena e mediave në raportim për ekstremizëm dhe radikalizëm. Kjo zyre vazhdimisht ka komunikuar me zyrtarët e kësaj njësie për rastet të cilat i kanë pasur gjatë ushtrimit të funksionit, si përshembul Zyra për Barazi Gjinore ka zhvilluar disa aktivitete nëpër shkolla si të evitohet dhuna në familje. Planin e veprimit të cilin plan është hartuar në bashkëpunim me expert ndërkombëtar, me disa takime pune, ku ky plan i ka përmbajtur të gjitha procedurat deri në aprovimin nga kuvendi komunal, ku në këtë plan të veprimit trevjeçar të gjitha drejtoritë kanë paraqitur rastet e tyre të cilat kanë nevojë për trajtimit. Plani i veprimit i hartuar nga komisioni i cili është zgjedhur nga ana e kryetarit të komunes vazhdimisht kanë paraqitur sfidat e tyre që po ballafaqohen gjatë zbatimit të këtij plani.

Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë periudhës janar – dhjetor 2024, ku prej tyre veçojmë:

- Monitorimi i ligjeve të aplikueshme në funksion të barazisë gjinore nga institucionet komunale dhe harmonizimi i akteve normative;
- Organizimi i fushatës “Java e edukimit për Barazi Gjinore”, ku në kuadër të kësaj fushate është organizuar një tryezë me akterët përgjegjës me temën “ Progresi i arritur për Barazi Gjinore dhe sfidat për të ardhmen, dhe njëkohësisht gjatë periudhës 01-08 mars janë mbajtur aktivitete të shumta në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas;
- Organizimi i trajnimit me gratë fermere të komunës së Vitisë për rolin dhe rëndësinë e marketingut të bizneset bujqësore, i cili u organizua nga Drejtoria e Bujqësisë dhe organizata KDC;
- U nënshkrua Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Komunës së Vitisë dhe USAID për realizimin e projektit për të drejtat pronësore, me theks të drejtat e grave në pronë, ku në kuadër të këtij projekti parashihen aktivitete të ndryshme me komunitetin e gjërë të komunës;
- Për promovimin e aktiviteteve të realizuara për avancimin e barazisë gjinore, Vitia në muajin qershor u përfaqësua në Konferencën Ndërkombëtare me temë: Roli i burrave në avancimin e barazisë gjinore”, ku morri pjesë nënkryetari i Komunës së Vitisë;
- Me 6 Qershor në bashkëpunim me NDI, u mbajt një tryezë diskutimi, me temë “ fuqizimi i grave në zonat rurale, ku morrën pjesë 30 pjesmarrse gra/vajza nga të gjitha zonat e komunës së Vitisë;
- Organizimi i takimit për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, forma e procedurave së aplikimit për përfitimin e pensioneve për këtë kategori Organizuar nga QPDG;
- Caktimi i indikatorve raportues për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe raportimi në ZKM/ZQM për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- Caktimi i indikatorëve për të drejtat e njeriut dhe raportimi në ZKM/ZQM;
- Raportimi në MAPL rreth të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe barazisë gjinore në veçanti;
- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit në referimin dhe shqyrtimin e ankesave të qytetarve për shkelje të drejtave të njeriut nga institucionet komunale;

- Ofrimi i rekomandimeve për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe barazinë gjinore në veçanti për drejtoritë komunale;
- Përfshirja e perspektivës gjinore në KAB-in 2025-2027 dhe caktimi i prioriteteve që eliminojnë pabarazitë gjinore në ndarjen e buxhetit komunal;
- Planifikimi i buxhetit komunal nga perspektiva gjinore;
- Analizë gjinore në Kulturë, Rini dhe Sport;
- Analizë Gjinore në sektorin e bujqësisë;
- Organizimi i trajnimit për teknikat e buxhetimit gjinor (pjesmarrës 15 nëpunës civil nga Administrata Komunale), mbështetur nga UN Women;
- Organizimi i trajnimit "Vlerësimi i ndikimit gjinor në politikat publike komunale" (pjesëmarrës 16 nëpunës civil nga Administrata Komunale), mbështetur nga UN Women;
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera: zhvillim ekonomik, punësim/mirëqenie sociale, shëndetësi dhe procesin e vendimarrjes;
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunësim) përmes ndarjes së granteve për zhvillimin e bizneseve në kulturat bujqësore, caktimi i masës afirmative për përfitimin e grantit (pajisjeve/serra)
- Hartimi dhe aprovimi i Planit për Barazi Gjinore për periudhën 2024-2026;
- Hatimi i Planit të veprimit të Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje 2024-2026, dhe ktivitete tjera të vazhdueshme.

Zyra për Prokurim

Në këtë raport kemi përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve dhe furnizimeve që janë domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të komunës, bazuar në kërkesën e njësisë shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njësisë buxhetore dhe mbarëvajtjes pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara në interes të komunitetit dhe mirëqenjes qytetare në përgjithësi. Këto aktivitete zyra i zhvillon bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e Prokurimit ka përgaditur këtë informatë për aktivitetet e prokurimit për vitin 2024, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër, ku përfshihen në këtë nëntëmujor. Në vitin 2024, duke u bazuar në kërkesat e njësisë shpenzuese, zyra ka inicuar 60 aktivitete të prokurimit, duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndarë në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna:

- 24 aktivitete me lëndë prokurimi shërbime;
- 16 aktivitete me lëndë prokurimi punë;
- 19 me lëndë prokurimi furnizime, dhe
- 1 Konkurs projektimi.

Nga këto aktivitete, 55 janë përbyll si aktivitete, tjerat janë në procedure, ndërsa lloji i procedurave i udhëhequr janë si vijon:

- 38 raste është përdorë procedura e hapur;
- 18 raste procedura e kuotimi i çmimit;
- 1 aktivitete procedurë me vlera minimale, dhe
- 3 aktivitete me procedurë të negocuar.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara, 55 aktivitete të prokurimit janë përbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave, ndërsa 1 aktivitet i prokurimit është në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm, dhe


katër aktivitete të anuluar. Zyra e Prokurimit përveç këtyre aktiviteteve ka nxjerr urdhërblert për operatorët ekonomik që kanë kryer punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë. Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është **9.512,801.21 €**.

Zyra e prokurimit gjatë kësaj periudhe kohore ka lëshuar **980 urdhërblertje** për pagesën e OE-së të kontraktuar, duke udhëhequr lëndet për kompletim dhe janë dërguar në thesar për pagesë, gjegjësisht ekzekutim. Zyra e Prokurimit ka kryer edhe **148 rekomandime** për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlersim dhe komisioneve tjera. Gjithashtu duhet potencuar se, Zyra e Prokurimit në nëntëmujorin e parë ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi.

Avokatit Publik I Komunës


Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2024, si përfaqësues ligjor kam kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji Nr. 08/L-227 për Përfaqësimin e Institucioneve Shtetërore në Procedura Gjyqësore, Ndërmjetësim dhe Arbitrazh, si dhe aktet tjera nënligjore. Gjatë ushtrimit të funksionit, në vazhdimësi përmes komunikimit formal dhe joformal jam konsultuar, udhëzuar dhe kam bashkëpunuar me Zyrën e Kryetarit si dhe me të gjitha drejtoritë përkatëse, rreth çështjeve relevante konkrete.

Në periudhën e lartcekur, kjo zyrë ka pranuar gjithsej **173 lëndë** të reja (të natyrës kontestimore, përmbartimore, administrative dhe penale), siç shihen në tabelën e mëposhtme:



kontestimore të pranuar, 7 prej tyre janë të natyrës pronësore, 12 të natyrës së kompensimit të dëmit, (zakonisht nga shpronësimet faktike pa procedurë të rregullt të shpronësimit, e që po i kushton komunës me humbjen e mjeteve), 79 lëndë ku si e paditur paraqitet QKMF në Viti, për kompensimin e pagave jubilarë dhe ato të 13-ta, si dhe 2 lëndë me baza të ndryshme. Nga lëndët përmbartimore gjithsej 63 lëndë, kryesisht janë lëndët e përfunduara me aktgjykim të plotëfuqishëm të trashëguara (të cilat nuk janë ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga Komuna), e që për të cilat nuk janë ushtruar mjetet e nevojshme me kohë, andaj nuk kemi pasur arsye dhe bazë ligjore të paraqesim prapësime, pasi vetëm se do të shkakttoheshin shpenzime të panevojshme.

Marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të lëndëve të pranuar, sipas autorizimeve që parashihen me ligjin e lartcekur, kam marrë veprimet si në tabelën e mëposhtme:



Varësisht nga statusi i lëndës, kam ushtruar 98 përgjigje në padi, kam marrë pjesë në 106 seanca (përfshirë edhe ato që janë shtyrë). Gjithashtu kam paraqitur mjetet e rregullta juridike në rastet ku kam vlerësuar se janë shkelur dispozitat ligjore apo nuk është vërtetuar gjendja e drejtë dhe e plotë faktike. Po ashtu, në bazë të autorizimit nga kryetari i komunës kam nënshkruar 4 kontrata të dhurimit të paluajtshmërisë, në të cilat komuna paraqitet si dhuratëmarrëse.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e Zyrës së Projekteve gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2024, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimit të tyre dhe mbikqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartpërmendura kemi kryer edhe këto punë, si:

- hartimin e detyrave projektuese;
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme;
- Pranime teknike të projekteve të përfunduara;
- Komisione të ndryshme për vlerësim;
- Menaxhimi i zbatimit të projekteve;
- Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menaxhmentit.

Lektori

Gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2024, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lektuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2024 kam lektuar këto dokumente:

- Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtoritë komunale 2023; Informatë e punës së kryetarit të komunës janar-qershor 2024, Raporti të drejtorive dhe zyrave, plane të punës, dëgjime buxhetore, vendime, procesverbalet e komiteteve, marrëveshje ndërkomunale, raporti i punës së burimeve njerëzore, raporti dhe plani i punës së DKA-së

- Procesverbalet e Kuvendit Komunal (mbledhja e X e 2023 dhe I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI 2024); Vendimet 26.01.2023, mbledhje solemne dhe të jashtëzakonshme; Vendimet 21.2.2022(4), Vendimet 26.03.2024(5), Vendim 25.04.2024 (1), Vendimet 23.05.2024(5), Vendimet 20.06.2023(8), Vendimet 23.09.2024(6), Vendimet 23.10.2024(4), Vendimet 21.11.2024(11), Ankesë 30.08.2024 (1).
- Komitetet: Komiteti për Komunitete (mbledhja e IX 2023, I, II, III, IV, V, VI 2024)
- Procesverbalet e KPF-së (mbledhja e XI e 2023 dhe mbledhjet I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI 2024).
- Procesverbalet e KKSBS-së (mbledhja e VII 2023 dhe mbledhja e I, II, III 2024).
- Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë sipas vendimeve të Zyrës së Kryetarit të Komunës (regjistrimi i pajisjeve dhe inventarit të administratës komunale).

Zyra për Integritime Evropiane

Zyra Komunale për Integritime Evropiane, zyrtari për integritime evropiane gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, ka kryer këto aktivitete:

- Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritime Evropiane 2024 dhe ju ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Plani Kombëtar për Integritime Evropiane 2024;
- Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiumit të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në;
- Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së;
- Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës;
- Kemi raportu ne ministri për realizimin e obligimeve që dalin nga plani për integritim përcjell komunave.

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Drejtoria për Administratë kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Vitisë. Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë: Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e kuvendit të komunës, trupave të kuvendit të komunës dhe këshillit të drejtorëve; Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr Kryetari i Komunës, Këshilli i Drejtorëve; Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e Administratës; Kujdeset për përkthimin e materialeve të Kuvendit, trupave të kuvendi dhe Këshillit të drejtorëve duke respektuar gjuhët zyrtare; Drejtoria e Administratës, ka realizuar objektivat të cilat dalin nga Plani i Punës së Drejtorisë për vitin 2024; Drejtoria për Administratë ka hartua planin e veprimit për muajt Janar dhe Dhjetor 2024 për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijnë nga bota e jashtme për pushime verore.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë. Kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë.

Ky sektorë ka përgatitë ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë; Komitetit për Politikë dhe Financa; Komitetit për Komunitete; Këshillit të Drejtorëve; Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 12 seanca të rregullta; të jashtëzakonshme 1; solemne 4; urgjente 0. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta; Komiteti për komunitete ka mbajtur 11 mbledhje, dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta. Kuvendi i komunës ka miratuar 1 rregullore, 2 ndryshim plotësim të rregullores dhe 64 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatitë për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrim të Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative, ditore, javore dhe mbledhje të rregullta, ku janë shqyrtuar materialet të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatitë materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje. Për nevojat e kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar dokumente të ndryshme, si: vendime, marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Dokumentet e hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve etj. Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulante në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKS, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën janar - dhjetor 2024

Nr	Përshkrimi i Lendeve	totali
1	Ekstrakt nga regjistri qendrori gjendjes civile	16417
2	Certifikata Lindjes	9598
3	Certifikata e martesës	3410
4	Certifikata e Vdekjes	1867
5	Certifikata Vendbanimi	1847
6	Deklaratë për bashkësinë familjare	4032
7	Certifikata e gjendjes martesore	1261
8	Certifikata e Shtetësisë	297
9	Vërtetim nga Arkivi	547
10	Vendimet	173
11	Aktvdekjet	208
12	Vërtetimi Mjeteve	53
13	Vizita	13
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	473
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	19
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	56
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	142
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	225
19	Kurorëzime të reja	415
20	Shkurorëzime	30
21	Humbje Shtetësie	19
22	Fitim Shtetësie	78
23	Clajmrim i vendbanimit	10
	Totali i dokumenteve të lëshuara	41190

Numri i përgjithshëm i dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 41190 dokumente.

III. Sektori i zyrës pritëse dhe arkivit

Zyra Pritëse në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese për periudhën janar-dhjetor 2024 janë, si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave, dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqit në formë tabelore.

· Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	56
· Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	70
· Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë	235
Kërkesa për regjistrim në LAV brenda vendit	142
Deklarata për vendqëndrim	
Deklarata për trashëgimi	0

Deklarata për përkujdesje financiare	54
Deklaratë për regjistrimin të më vonshëm në LAL	3
Deklarata për regjistrim në LAV	32
Gjithsejtë:	822

LËNDËT E ARKIVUARA

Drejtoritë	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	301
Drejtoria për Administratë	34882
Drejtoria për Arsimit	1413
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	53
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	1506
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	347
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	107
Drejtoria e Inspeksionit	75
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1113
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	4788
Kuvendi i Komunës	3
Zyra e Kryetarit	652
Zyra për Komunitete	1
Totali	45238

IV. Sektori i administrimit

Ky sektor përfshinë shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë: Kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për punë më efikase dhe menaxhim me të suksesshëm në këtë sektor duhen të bëhet renovimi i objekteve komunale, autoparkut dhe krijim i hapësirave të nevojshme për punë. Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën janar - dhjetor 2024. Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë: 47741 euro.

- Administrata.....10506 €,
- Shëndetësia 20473 € dhe
- Njësia e zjarrfikëseve..... 16762 €

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, gjenerator, nxehe qendrore dhe autorizime për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 50351 litra. Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 42106 litra:

- Administrata.....16965 litra,(z. e kryetarit, DKA dhe autorizimet)
- Shëndetësia 23490 litra dhe
- Njësia e zjarrfikës.....9896 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehe qendrore për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 6890 litra naftë:

- Administrata..... 3400 litra
- D. E kulturës..... 0 litra
- Shëndetësia 3490 litra,
- Njësia e zjarrfikësve.....0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësitë shpenzuese janë 2978 litra:

- Administrata..... 135 litra,
- Shëndetësia..... 1067litra,
- Njësia e zjarrfikësve..... 706 litra.
- DKA-ja (Shkollat) 1070 litra.

Shpenzimet e sigurimeve te automjeteve 9.389.91 eu.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësorë, në veçanti:

- Ka zbatua hardëre, Softuerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçje sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

PËR PERIUDHËN janar-qershor 2024

Nr.	Emërtimi	Nr.Intervenimeve	Vërejtje
1	<i>Risetimi i passëord të Domenit</i>	220	
2	<i>Hapja e Userve të Domenit</i>	13	
3	<i>Hapja e Userve të Intranetit</i>	7	
4	<i>Intervenimet në Usera</i>	100	
5	<i>Intervenimet në rrjetin qeveritar</i>	70	
6	<i>Intervenimet në programe</i>	130	
7	<i>Instalimi i programeve aplikative</i>	75	
8	<i>Intervenimet në Gjendjen Civile</i>	60	
9	<i>Intervenimet në Tatimin Pronë</i>	60	
10	<i>Futja e kompjuterëve në Domen</i>	50	
11	<i>Instalimi i softëare</i>	0	
12	<i>Instalimi i computerhardëaredevices</i>	0	
13	<i>Rregullimi kabllorë të internetit</i>	80	
14	<i>Intervenimet në E-mail</i>	35	
15	<i>Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal</i>	48	
16	<i>Intervenimet në Intranet</i>	60	
17	<i>Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës</i>	0	
18	<i>Drejtoria Arsimit</i>	30	
19	<i>Qendra për punë sociale</i>	40	
20	<i>Telefonave VOIP</i>	3	
21	<i>Asistimi ne rregullimin e fotoko.,printe etj</i>	250	
22	<i>Përkrahja ne takime virtuale</i>	0	
	Gjithsëjtë	1331	

1. Mirëmbajtja e Serverit
2. Mirëmbajtja e Intranetit
3. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile
4. Mirëmbajtja e-pasurisë
5. Sistemi për menaxhimin dhe arkivimin elektronik të dokumenteve
6. Menagjimi i disa kontratave
7. Trajnime të ndryshme virtuale dhe fizike

Zyrtari për pranimin e mallit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ka punuar në harmoni me përshkrimin e vendit të punës, ku ka realizuar objektivat që parashihen me planin e punës gjatë kësaj periudhe. Furnizimi i mallrave është bërë sipas kërkesës nga njësitë përkatëse nga drejtoritë, duke u bazuar në kontratë.

Pranues i mallrave ka kryer këto detyra të punës: Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në sistemin e menaxhimit të pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet komunale ku vlera e këtyre materialeve është 78,014 € apo 91 lëndë; Janë bërë mbi 120 kërkesa për furnizime me material për zyre dhe inventar; Janë bërë furnizime me material shpenzues si dhe inventar për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë, duke përfshirë Zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtoritë tjera dhe komunitetet, si dhe janë realizuar mbi 1200 pagesa në sisteme pagesave SIMFK; Kemi asistuar në disa paramasa për furnizim me material shpenzues si dhe ka kryer detyra tjera që iu janë besuar nga menaxhmenti i Komunës.

Drejtoria për Inspeksion

Kam kënaqësinë që me ju sot të ndajë punën tonë të Drejtorisë së Inspeksionit për periudhën raportuese janar dhjetor të viti 2024. Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare është bërë punë e konsiderueshme në të gjithë sektorët në Drejtorinë e Inspeksionit me një qëllim të vetëm që të jemi në shërbim të qytetarëve në ruajtjen dhe kujdesin e ambientit të përgjithshëm, duke e respektuar ligjin dhe duke bërë inspektime të rregullta. Tutje paraqes punën për të gjithë inspektorët.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Inspeksionit është e organizuar në:

1. Udhëheqësi i Sektorit për Inspektime, z. Faton Ahmeti;
2. Inspektori i mbrojtjes së ambientit, z. Afrim Sylejmani;
3. Inspektori i Komunikacionit, z. Granit Shaqiri;
4. Inspektorët e ndërtimit (dy inspektor), z. Hajredin Aliu dhe Arenë Emini;
5. Inspektorët e tregtisë (dy inspektor), z. Fehmi Ismajli dhe Dardan Zeqiri;
6. Zyrtar për menaxhim financiar dhe kontroll, z. Shkelzen Haliti;
7. Gjeodeti (zyrtari për matje, rrjet dhe gjeometër), (mungesë);
8. Inspektori i shërbimeve publike (mungesë);
9. Inspektoi i uzurpimit të pronës komunale, (mungesë).

Mbetët sfidë organizimi i stafit dhe i drejtorisë. Presim rekrutim gjatë fillimit të vitit 2025 me pozitat të cilat janë të lira, siç është inspektori i shërbimeve publike, inspektori i uzurpimeve të pronës komunale si dhe gjeodeti (zyrtari për matje, rrjet dhe gjeometër). Gjithashtu sfidë e madhe mbetet edhe mungesa e pajisjeve teknike dhe automjeteve të cilat janë të domosdoshme për realizimin e punës në Drejtorinë e Inspeksionit, nvojitet edhe një kompani për rrënimin e objekteve pa leje dhe lirimit të hapsirës publike. Më tutje paraqes punën për të gjithë inspektorët për vitin 2024.

Udhëheqsi i Sektorit Për Inspektim

1. Mbështet dhe ofron këshilla për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe mbikëqyrësin për fushën e përgjegjësisë së sektorit që udhëheqë
2. Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e sektorit dhe siguron funksionim efikas të tij, si dhe ndihmon Udheheqesin e drejtperdrejt të tij në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave
3. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analiza të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes
4. Planifikon, përgatit, monitoron dhe analizon buxhetin e sektorit si dhe aktivitetet tjera të sektorit dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit
5. Organizon dhe shpërndan punën për stafin të tij/saj dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësit e sektorit
6. Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse
7. Me autorizim të mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësisë së sektorit të cilin e udhëheq
8. Siguron komunikimin brenda dhe jashtë njësisë organizative dhe institucionit me qëllim të mbledhjes ose shkëmbimit të informacionit.
9. Bën vlerësimin e rezultateve të punës për stafin nën mbikëqyrje të tij/saj dhe identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Inspektorët e tregut

- Procesverbale në aspektin e zbatimit të ligjit për Nr:03/L-186, Ligjit 04/L005 , dhe ligjit 06/L-034, kryesisht detyrim i legalizimit të veprimtarisë ,ndërrimet e lokaleve, si dhe pajisjet me aktvendimet të pranimeve teknike.....119
- Inspektim në zbatim të masave- matje të peshës-sasin e produkteve në furat e bukës ,ku kryesisht janë verifikuar sasit dhe është kërkuar që ti shpallin deklaracionet mbi peshën cmimet dhe përmbajtjen e produkteve.....29
- Kontroll mbi etiketen,deklaracionin dhe flamurin e origjinës së produkteve.....45
- Inspektim në fushën e kontrollit, identifikimit të rritjes së cmimeve të artikujve bazik siq janë vaji dhe produktet tjera bazike ,dhe në bashkrendim me institucionet e Inspektoratit të tregut në kuadër të MTI-së dhe udhëzimeve të pranuar.....18
- Inspektim mbi cmimet dhe sasin e dhe llojin e furnizimit të plehut artificial në barnatoret bujësore,ku janë evidentuar furnizuesit e shitësve me pakicë, cmimet ,llojet dhe sasia në dispozicion për fermeret.....15
- Kontroll për ndalim të artikujve-lodra për fëmijë-imitim i rrezikshëm i produkteve ushqimore,kryesisht inspektimet janë fokusuar në veprimtarit gjithëcka 1 €,por edhe në supermarketet që posedojnë artikuj të tillë.....21
- Inspektim në njoftim dhe largim i disqeve për prerje të metalit dhe betonit me afat të skaduar,
- Kërkesa për pranime teknike të lokaleve.....42
- Aktvendime për pranime teknike të lokaleve.....42
- Kërkesa për pranimin teknik të lokaleve në shumë prej 2470 EURO.
- Procesverbale të komisionit për pranim teknik.....55

- 3 gjoba të shqiptuara (3x1000), në vlerë totale3000 EURO.
- Inspektime në njoftim dhe largimin e disqeve për prerje të metalit dhe betonit me afat të skaduar.
- Gjatë kësaj periudhe si biznesi që kanë startuar, kryesisht veprimtarit si butiqet, kafiteritë apo restorantet, ndërsa trendi i kërkesave ka qenë kryesisht nga lëmia e pompave të derivateve të naftës dhe produkteve të saj, si dhe vizita tjera në biznese, në aspektin e zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-186 dhe dispozitave tjera mbi peshën dhe njesitë matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit, biznesit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë, e sidomos pajisje me pranim teknik të lokalit.....133.

Inspektori i mbrojtjes së mjedisit

- Procesverbale të shkruara në teren.....28
- Shpërndarje të njoftimeve për mbrojtjen e mjedisit13
- Inspektime në teren, në gjithë territorin e Komunës së Vitisë.....314
- Dalje në teren lidhur me mbeturinat në hapësira publike135
- Dalje në teren pas përfundimit të orarit të punës..... 2
- Gjoba mandatare të shqiptuara sipas Rregullores komunale për gjoba dhe ngarkesa.....5
- Konsultime me palë në zyrë lidhur me kërkesat e tyre.....243
- Kryerja e inspektimeve të përbashkta me inspektorin e ndërtimit.

Inspektori i ndërtimit, Hajredin Aliu

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin 2024, sipas dinamikës së punëve kemi realizuar këto objektiva: Aktivitete sipas detyrës zyrtare: Zbatimi i Ligjit të Ndërtimit me Nr.04/L-110, të datës 31 Maj 2012 të Kuvendit të Kosovës dhe Rregullores komunale mbi ndërtimet; Aktivitetet dhe detyrat sipas urdhrave të drejtorisë dhe eprorëve të tjerë nga Komuna e Vitisë.

Bazuar në planin e punës sipas dinamikës kemi pasur këto aktivitete: Parandalimi i ndërtimeve pa leje përkatëse të ndërtimit; Përgatitja e planeve dhe raporteve të punës sipas periudhave mujore; Koordinimi i veprimeve në bashkëpunim me drejtoritë tjera komunale; Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit etj.

Në kuadër të aktiviteteve sipas detyrës zyrtare kemi pasur mjaftë angazhime rreth kontrollimit të ndërtimeve në Komunën e Vitisë, ku kemi konstatua këtë gjendje: Në disa raste të ndërtimit pa leje përkatëse, pas intervenimit tonë dhe hartimit të procesverbalit, shumë nga ndërtuesit i kemi detyruar që të pajisen me leje përkatëse të ndërtimit; Disa raste kemi bërë edhe vendime për ndërprerjen e punimeve dhe janë vendosur shiritat për ndalimin e punimeve të mëtuqeshme; Gjatë këtij viti përpos angazhimeve tona zyrtare kemi pasur edhe disa kërkesa nga ana e qytetarëve në lidhje me ndërtimet, si ato banesore dhe të rrugëve, ku një mori kërkesash i kemi shqyrtuar së bashku me kolegët tanë në afatin optimal.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiive tona në këtë vit kemi hartuar gjithsej:

- Procesverbale nga vendi i ngjarjes.....45
- Aktivitete në teren kemi pasur 120 raste të kontrollimeve.....120
- Vendime për ndërprerjen e punës.....10
- Vendosjen e shiritave për ndërprerjen e punimeve.....10
- Kemi pregaditur mbi 9 lëndë të cilat i kemi të proceduar në Prokurorinë themelore në Gjilan.....9
- Kemi hartuar 10 Vendime për rrënime të rasteve të ndryshme.....10

Kemi përfaqësuar në Gjykatën Themelore në Gjilan - Dega në Viti. Gjithashtu në kuadër të aktiviteteve tona kemi qenë të angazhuar me vendim të kryetarit të komunës edhe në shumë raste të pranimeve teknike si:

kanalizime, shtrirje të rrjetit të ujësjellësit, rrugë të ndërtuara, trotuare, ku për secilin rast kemi hartuar raporte pune veç e veç.

Bazuar në të dhënat e aktivitetit tonë në teren dhe gjendjes faktike në fushën e ndërtimit në Komunën e Vitisë, mund të thuhet se, në përgjithësi gjendja është nën kontroll, edhe pse kemi mjaftë shkelje të procedurave përkatëse për ndërtim. Në shumë raste kemi kërkesa nga pronarët për ndërtim, por kërkesat e tyre janë në procedurë e sipër në zyrën e urbanizmit, për arsye të ndryshme.

Vështrësitë: Gjatë këtij viti në vazhdimësi jemi përballur me mungesën e mjeteve teknike si dhe mungesën e efikasitetit të Gjykatave, ku ngelin lëndët në procedurë. Nga kjo neglizhencë e gjykatave mund të konstatojmë se, palët nuk i përfillojnë mjaftueshëm vërejtjet tona.

Inspektorja e ndërtimit

Në bazë të planit dhe programit të punës për këtë periudhë kemi zhvilluar këto aktivitete: Procesverbale në aspektin e zbatimit të Ligjit të Ndërtimit Nr:04/L-110, Ligjit 04/L-175 dhe Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017, kryesisht për vizitën inspektuese mbi gjendjen faktike 98

Inspektime në mbikëqyrje inspektive të fazave të ndërtimit.....	120
Aktvendime për ndërprerje të punimeve.....	32
Kallëzime penale.....	24
Vendime për rrënim.....	24

Inspektori i komunikacionit per periudhen tetore-dhjetore 2024

Kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarë të ndryshëm si dhe subjekte, operatorët e transportit. Po njëjtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e auto-shkollave dhe subjektet tjera që ishin të lidhur apo të interesuar për gjendjen në komunikacion, si shoqëri civile, media etj. Kemi hartuar procesverbale mbi shikimin e automjetit për transport publik –taxi.....17

Kemi bërë 17 fletëpagesa për taksa komunale dhe atë mbi shikimin e automjetit - 17x10 € = 170 Euro	
Kemi bërë Njoftime.....	3
Gjoha Mandatore	2

Zyrtar për menaxhim financiar dhe kontroll

Planifikimin e buxhetit të Drejtorisë së Inspeksionit. Në komisionin për mbylljen e arkave të komunës, si kryetar komisioni, ku inkasohen të hyra nën 10€. Pranimin e faturave hyrse të drejtorisë, procedurat e zotimit të mjeteve nga buxheti i komunës, deri në fazën finale të pranimit të mallit-shërbimit. Mbikëqyrjen e veturës: kilometrazhin, kontrollimin teknik dhe mirëmbajtjen e tij. Listën e vijueshmerisë në baza ditore. Kam kryer edhe punë të tjera me urdhër të drejtorit dhe udhëheqesit të inspeksionit.

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

DSHPE-ja në bazë të organogramit është e përbërë nga dy sektorë. Sektori i Shërbimeve Publike dhe Sektori i Emergjencës. Sektori i Shërbimeve Publike ka katër zyrtarë, ndërsa Sektori i Emergjencës tre zyrtarë. Në kuadër të drejtorisë, Sektori i Emergjencës është edhe shërbimi i njësitit të zjarrfikësve, që ka 25 punëtorë profesional, si dhe inspektorin e preventives ndaj zjarrit.

Sektori i shërbimeve publike

Gjatë periudhës janar – qershor 2024, ky sektor ka pranuar gjithsej 172 kërkesa të natyrave të ndryshme, 141 kërkesa janë miratuar, 31 janë në proces për shqyrtim të cilat i kemi kryer në afatin ligjor. Kemi lëshuar vendime të ndryshme, leje për parkim, vazhdimi i lejeve për auto-taxi dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike,

si dhe janë bërë pagesa për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj. Gjatë kësaj periudhe kemi përcjell punët e operatorve të kontraktuar nga komuna, të cilit kanë kryer shërbime për komunën.

Buxheti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

DSHPE-ja për vitin 2024 ka pasur buxhetin e përgjithshëm në të gjitha kategoritë ekonomike të aprovuar dhe atë në shumë prej 1.384.564.18€, ndërsa gjatë kësaj periudhe janar – qershor 2024 është shpenzuar 907.701.66 €, në përqindje 65.%.

Mirëmbajta verore – dimërore e rrugëve lokale

Kemi përcjellë punët e operatorit ekonomik SH.P.K “Zuka” për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve, si: pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushjen e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barojat dhe shkuret etj.

Mirëmbajtja e HHP

- Mirëmbajtjen e HHP gjatë periudhës raportuese e ka bërë operatori ekonomik Shpk “Arbor Group” nga Kamenica;
- Janë përcjellë punët për mirëmbajtje dhe pastrim të qytetit dhe HHP në bazë të kontratës dhe paramasës;
- Me Hapësira të Hapura Publike (HHP) të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Komunës së Vitisë;
- Janë mirëmbajta parqet, sheshet, shëtitortja Viti-Binçë, shtrat i lumit “Morava”, sipërfaqe gjelbëruese, hapësirat për parkim automjesh, hapësirat përreth objekteve sakrale (fetamonumentale), rrugët, trotualet, tregjet, lapidarë, pllakat përkujtimore, varrezat e dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë, është bërë edhe krasitja e drunjeve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjeve dekorativ, mbjellja e luleve në qytet etj.

Pastrimi i objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore

Me pastrimin e objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore është marrë kompania, “Aroma Plus” sh.p.k & “Krasniqi” Shpk, Ntp “Beni” nga Pritishtina. Të gjitha objektet komunale shëndetësore dhe arsimore janë mirëmbajta siaps kontratës dhe paramasës.

Ndriçimi publik

Gjatë kësaj periudhe të raportimit është lidhur kontrata për ndriçimi publik, ku në këtë kontratë parashihet ndërrimi i poqave elektrik me poqa elektrik me rreze solare në gjithë vendbanimet e Komunës së Vitisë.

Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit

Me këtë projekt njëvjeçar mirëmbahen aparatet kundër zjarrit për NJPZ, institucionet komunale, arsimore dhe shëndetësore.

Ujësjellësi dhe kanalizimi

Në komunën tonë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit përgjegjëse është kompania regjionale “Hidromorava”, njësi në Viti. Kompania në fjalë bënë furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmbanë kanalizimin në qytetin e Vitisë, Drobesh, Ramnishte, Pozharan, Qifllak, Letnicë. Gjatë kësaj periudhe të raportimit kanë hyrë në menaxhimin e kompanisë regjionale “Hidromorava”, njësi në Viti edhe 5 fshatra, ato janë: Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Ulët, Tërstenik, Sodovinë e Jerlive, Sadovinë e Qerkezëve, ndërsa në lokalitetet tjera, ku rrjetet e ujësjellësive dhe rrjetet e kanalizimeve nuk mirëmbahen nga kompania regjionale “Hidromorava”, njësi në Viti, mirëmbahen nga operatori ekonomik “Vizioni BD”, i kontraktuar nga Komuna e Vitisë.

Mbeturinat

"Eco-Higjiena" si kompani publiko-private, njësia në Viti, bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponin regjionale ne Velekincë të Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të Komunës: Qyteti i Vitisë, Drobesh, Smirë, Terpezë, Pozheran, Sllatinë e Eperme, Sllatinë e Ulët, Radivojcë, Fshati Ri, Budrikë, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Germovë, Sodovinë e Jerlive, Sadovinë e Qerkezeve, Verban, Ramnisht, Goshicë, Skifteraj, Tërstenik, Podgorc, Stubëll e Epërme, Lubishtë, Binçë, Devajë dhe Qifllak, Letnicë.

- Numri i ekonomive familjare që janë në sistem e grumbullimit të mbeturianve gjatë 6-mujorit të 2024 në Komunën e Vitisë janë 5749;
- Numri i bizneseve janë 464;
- Numri i institucioneve 58;
- Numri përgjithshëm i ekonomive familjare, bizneseve, institucioneve është 6246 që janë në sistem e grumbullimit të mbeturianve.

Deponit ilegale

Më datë 15.06.2024 janë evidentuara katër (4) deponi ilegale dhe të pastruar, ku edhe raportuar në AMMK Agjencioni I Menagjimit të Mbeturinave të Kosovës.

Tabele e kordinatave gjeografike të secilës deponie aktuale

Nr	Madhësia	Vendi ku ndodhet	Gjerësinë	Gjatësinë	Lloji	Komuna
1.	E mesme	Pozheran	42.352099	21.9132	A.N	Viti
2.	E mesme	Devajë	42.393815	21.395977	N	Viti
3.	E mesme	Beguncë	42.35619	21.354725	A	Viti
4.	E mesme	Sllatinë e Ultë	42.297151	21.390048	A	Viti

Punët me Skipin e Komunës

Hapja e kanaleve të ndryshme, largimin e borës nga rruga, largimin e mbeturinave, varrosjen e kafshëve të ngordhura, mbyllja e rrugëve malore, rregullimi i hapësirave publike dhe rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erosive. Pra, me skipin e komunës janë kryer punë të ndryshme dhe atë në total 240 orë pune.

Spektori i emergjencave

1. Kordinimi i aktiviteve me reagusit komunal dhe me nivel regjional.
2. Punët e përditshme administrative.
3. Përgatitja e materialeve për vërshime për nivelin qendror. (dëmet mahershme, gjendja e lumenjve dhe prockave, vlerësimi i rrezikut, etj.
4. Implementimi i vendimeve të kryetarit të komunës në komisione komunale.
5. Azhurimi i të dhënave dhe dërgimi në AME, Qendra Operative Lokale.

Njësia profesionale e zjarrfikjes dhe shpëtimit

2023	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Gjithsej
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	10	4	3	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	10
Shkurt	60	56	0	3	1	0	0	0	0	0	0	0	0	60
Mars	30	22	3	4	1	0	0	0	0	0	0	0	0	30
Prill	30	24	0	5	1	0	0	0	0	0	0	0	0	30
Maj	17	3	0	12	1	1	0	0	0	0	0	0	0	17
Qershor	37	22	2	9	3	1	0	0	0	0	0	3	3	37
Corrik														
Gusht														
Shtator														
Tetor														
Nëntor														
Dhjetor														
Gjithsejtë	184	131	8	33	7	5	0	0	0	0	0	3	3	184

Inspektori i preventives ndaj zjarrit

- Inspektime të përgjithshme (të rregullta dhe verifikuese).....28
- Inspektime në sektorin privat.....23
- Inspektime në sektorin shoqror(public).....5
- Nr.Vrejtjeve92
- Nr.Propozim të masave.....92
- Shiqime në vendngjarje të zjarreve.....12
- Raporte zjarri për njësitin hetues në polici(prokurori).....12
- Kërkesa nga palët.....2

Drejtoria për Shëndetësi dhe Shërbime Sociale

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

1.Shërbimet primare:

- a. Mjekësia Familjare,
- b. Emergjencia,
- c. Stomatologjia,
- d. Imunizimi dhe vaksinimi,
- e. Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik),
- d. Barnatorja.

2. Shërbimet specialistike

- a. Pediatria,
- b. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti),
- c. Gjinekologjia.

I. Shërbime primare

Në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24 orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës. Qendra e urgjencës primare punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës, ndërsa mjekësia familjare punon në orarin 08.00-15.00 çdo ditë të javës. Gjatë vitit 2024 në QKMF janë ofruar 556760 shërbime shëndetësore.

Mjekësia Familjare

- Ka ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë dhe të një numër të konsiderueshëm të Komunës së Kllokotit të të gjitha moshave pa dallim. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **31337** vizita mjekësore.
- Gjithashtu është kryer kontrolla sistematike e nxënësve të klasave I, V dhe të IX të të gjitha shkollave të Komunës së Vitisë. Janë kontrolluar 1470 nxënës, ku janë vlerësuar 29 parametra shëndetësorë dhe 13 parametra të shëndetit oral.

Shërbimi i urgjencës primare

Shërbimi i urgjencës ofron shërbime shëndetësore **24 orë në ditë** gjatë tërë javës. Në shërbimin e urgjencës kryhen të gjitha shërbimet e ndihmës së parë, kontrolla mjekësore, këshilla, vizita në teren gjatë traumave dhe aksidenteve të ndryshme, kirurgji e vogël, ndërrim kateteri, lidhje dhe pastrimi i plagëve, ordinimi dhe trajtimi me terapi parenterale, oksigjenoterapia etj. Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës, vikendeve dhe festave në bazë të orarit të planifikuar më parë. Autoambulancat janë monitoruar në vazhdimësi nga ekipet kujdestare dhe vozitësit, në drejtim të funksionimit sa më të rregullt të saj. Në dispozicion kemi 6 autoambulanca në funksionalitet të plotë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **71997** vizita mjekësore në shërbimin e urgjencës, ndërsa në tërësi janë ofruar **151436** shërbime.

Stomatologjia

Shërbimi i stomatologjisë ka ofruar shërbime stomatologjike në orarin 8:00-15:00. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran.

Shërbimet të cilat ofrohen janë:

- Preventivë,
- Shërim i dhëmbit,
- Drenim,
- Incizion i dhëmbit të infektuar,
- Mbushje e dhëmbit,
- Shërbimet e pedodontisë,
- Pastrim të gurëve në dhëmbë,
- Nxjerrje e dhëmbit etj.

Gjatë këtij viti janë ofruar **10046** shërbime stomatologjike.

Shërbimi i Vaksinimit

- Shërbimi i vaksinimit në mënyrë të vazhdueshme ka punuar në ngritjen e cilësisë profesionale të stafit shëndetësor. Po ashtu edhe në edukimin e qytetarëve në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e promovimit dhe parandalimit të sëmundshmërisë së fëmijëve dhe rëndësinë e vaksinimit në fëmijëri;
- Ka bërë planin vjetor dhe ka realizuar planin në përpikmëri në vaksinimin e fëmijëve parashkollor dhe shkollor në tërë territorin e Komunës së Vitise dhe Komunës së Kllokotit;
- Është bërë vaksinimi i popullatës me vaksinën e gripit sezonal.

- Gjatë tërë vitit janë planifikuar të vaksinohen **2180** fëmijë, ndërsa janë vaksinuar 2106 dhe shkalla e vaksinimit për fëmijë në këtë vit është në përqindje 96.6%;
- Me HPV janë planifikuar 275 vajza, ndërsa janë vaksinuar 289 ose në përqindje 105%, pasi që ka pas të interesuar edhe mbi moshën 12 vjeçare vajza që janë vaksinuar;
- Gjithsejt në shërbimin e vaksinimit janë ofruar **13020** shërbime.

Laboratori

Shërbimi i laboratorit ofron shërbime në orarin 8:00 - 15:00. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran. Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të laboratorit. Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime laboratorike në institucionin tonë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar 109872 shërbime laboratorike, ndërsa shpenzimet për laborator kanë qenë 21307 euro.

Shërbimi radiologjik

Gjatë vitit 2024 shërbimi i rentgenit ka qenë në renovim. Në nëntor është rifunksionalizuar. Gjithashtu, jemi licencuar nga ministria për mbrojtje dhe rrezatim nga Qeveria e Republikës së Kosovës për ofrim të shërbimeve radiologjike. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar **255** shërbime radiologjike. Rentgeni punon në orarin e rregullt 8:00-13:00.

Barnatorja

- Është bërë planifikimi me kohë për furnizim me barna dhe material hargjues për vitin 2023;
- Janë kryer në mënyrë të rregullt porositë mujore për furnizim me barna dhe material hargjues nga Ministria e Shëndetësisë, kryesisht përmes sistemit SMFK;
- Është bërë distribuimi i barnave dhe materialit hargjues në QKMF dhe QMF-Pozheran si dhe të gjitha QMF-të dhe AMF-të;
- Është bërë furnizimi i pacientëve me barna esenciale dhe insulin;
- Furnizimi me barna përmes listes esenciale ka qenë në përqindje 29.53 %, ndërsa me material hargjues 65.34 %;
- Për faktin që furnizimi ka qenë jo i kënaqshëm nga MSH përmes listës esenciale, jemi obliguar të blejmë terapi dhe material shpenzues përmes kodit, shërbime dhe mallra.
- Gjatë kësaj periudhe kemi blerë me mjete vetanake, përmes kontratës me operatorin ekonomik në kuadër të shërbimeve dhe mallrave terapi dhe material hargjues në raste specifike në vlerë prej **102.738.18** euro.

2. Shërbimet specialistike

Pediatria

Shërbimi i pediatriës ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00 çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore. Gjatë këtij viti janë ofruar **3404** vizita mjekësore dhe **425** këshilla mjekësore. Ne total janë ofruar **3829** shërbime pediatrike.

Mjekësia interne

Shërbimi i mjekësisë interne ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00 - 15:00 çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore kryesisht për të sëmurët kronik. Sëmundjet më të shpeshta kronike të evidentuara në shërbimin e mjekësisë intern janë sëmundjet kardiovaskulare, reumatologjike dhe të

diabetit. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar 645 vizita mjekësore si dhe janë realizuar 498 EKG. Në total janë ofruar 1664 shërbime.

Gjinekologjia

Shërbimi i gjinekologjisë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00 - 15:00 çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore për gratë shtatzëna. Gjatë këtij viti janë ofruar 2099 vizita mjekësore dhe 1386 ultrazë, 705 kontrolla gjinekologjike dhe 450 këshilla. Në tërësi janë ofruar 4844 shërbime shëndetësore në gjinekologji. Gjithashtu, në këtë shërbim funksionojnë “klasat për nëna”, ku gjatë kësaj periudhe janë ofruar 574 shërbime dhe “kujdesi në 1000 ditët e para” me 3 grupe të grave shtatzëna. Gjatë vitit 2024 janë bërë renovime në repart.

Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

Kemi vazhduar me programin e vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer 1360 vizita. Përpos këshillave mjekësore, në raste të veçanta përmes donatorëve, familjet janë ndihmuar edhe me pako ushqimore dhe higjienike. Përpos infermiereve për vizita shtëpiake, kemi angazhuar edhe logopede dhe psikologe, për të ofruar ndihmë për fëmijët që kemi hasur në probleme në të folur gjatë këtyre vizitave dhe probleme tjera eventuale. Gjatë këtij viti janë trajtuar 9 fëmijë, por e kemi ndërprerë programin për shkak të punimeve në repart.

Kujdesi paliativ

Shërbimi i kujdesit paliativ ka kryer me profesionalizëm shërbimet shëndetësore ndaj pacientëve me sëmundje kronike dhe atyre të pa lëvizshëm, jo vetëm në Komunën e Vitisë, por edhe në Komunën e Kllokotit. Në QKMF Viti funksionojnë dy ekipe në teren, në orarin 8:00 - 15:00, ndërsa prej orës 15:00 vizitat në teren i kryen shërbimi i urgjencës. Gjithashtu është edhe mjeku në permanencë, i cili aktivizohet në punë varësisht nga rastet ditore, kur ka nevojë për shërbim të mjekut. Gjatë vitit 2024 janë ofruar 4096 shërbime shtëpiake, kurse vetëm shërbimi i urgjencës ka ofruar 2113 vizita në teren.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Pozheran

QMF në Pozheran ofron shërbime shëndetësore 24 orë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet stomatologjike si dhe kryhen shërbimet laboratorike gjatë ndërrimit të pare, kurse shërbimet e kujdestarisë ofrohen 24 orë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar 42339 vizita shëndetësore, kurse janë ofruar 30231 shërbime infermierore. Në shërbimin e stomatologjisë 729 vizita, kurse janë ofruar 1330 shërbime stomatologjike. Në shërbimin laboratorik janë ofruar 5360 vizita laboratorike dhe janë ofruar 57981 analiza laboratorike.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme

Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierike dhe mjeku 1 ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar 143 vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar 850 shërbime.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Smirë

Në QMF-në në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku 1 ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar 28 vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar 352 shërbime.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Sadovinë të Jerlive

Në QMF-në në fshatin Sadovinë të Jerlive punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku dy ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **63** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **284** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Skifteraj

Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve, përveç vikendit, ndërsa mjeku dy ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **112** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **162** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Beguncë

Në AMF-në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermierike çdo ditë pune përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **36** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **342** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Terpezë

Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermierët, ndërsa mjeku 5 ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **767** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **459** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Stubëll e Epërme

Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **188** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **1169** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Letnicë

Në AMF-në në Letnicë shërbimet shëndetësore nga infermierja ofrohen çdo ditë dhe mjeku ofrohen një ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **966** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **492** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Remnik

Në AMF-në në fshatin Remnik punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë vitit 2024 është ofruar **1** vizitë mjekësore, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **33** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Gushicë

Në AMF-në në fshatin Gushicë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë vitit 2024 janë ofruar **14** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **32** shërbime.

Sistemi Informativ Shëndetësor

Janë raportuar me kohë të gjitha raportet në të gjitha institucionet përgjegjëse, si: IRSHP - Gjilan, IKPSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Është përcjellur gjendja e sëmundshmërisë përmes formularëve të caktuar dhe është raportuar me kohë në institucionet përgjegjëse.

Tabela e raportit të SISH për periudhën janar - dhjetor 2024

REPUBLIKA E KOSOVES - KOMUNA E VITISE
RAPORTI DITMORSHKUP REALIZUES
JANAR - DHJETOR 2024

Regjistrimi	QKMF	QMF	AMF	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	... (të tjera)	
10000
...

Shërbimet e ofruara nga punëtorët e angazhuar përmes kontratës për shërbime shëndetësore
 Komuna e Vitisë ka lidhur kontratë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe kujdes paliativ në QKMF-Viti, duke llogaritur nevojën dhe kërkesën e madhe për stafë shëndetësorë. Në këtë kontratë janë të angazhuar mjekë, stomatolog, infermier, mami, laborant, teknikë të farmacisë, vozitës si dhe punëtorë teknik, të cilët ofrojnë shërbime sipas nevojave, qoftë në QKMF, QMF apo AMF. Numri i stafit ka qenë variabil gjatë tërë vitit.

Cilësia e shërbimeve shëndetësore:

- Janë mbajtur takime të rregullta të Këshillit Drejtues të QKMF-së në Viti;
- Është bërë me kohë plani i punës;
- Janë mbajtur takime me përgjegjësit e njësive, në mënyrë të evitimit të parregullsive dhe avancimit të shërbimeve sa më cilësore;
- Janë diskutuar në takime të rregullta planet, kërkesat dhe sfidat e çdo shërbimi;
- Janë mbajtur takime edhe sipas kërkesave të stafit.

Shërbimi i administratës

Buxheti i Shëndetësisë përbëhet nga granti specifik i shëndetësisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të hyrat vetanake. Për vitin 2024 ky buxhet ndahet si vijon:

- Paga dhe Meditje, 1.326.303,
- Mallra dhe shërbime, 645.235,
- Shpenzimet Komunali, 40.000,
- Shpenzimet kapitale, 110.000,
- Totali: 2.156.046 euro.

Shërbimi i administratës ka funksionuar me kapacitet të plotë, ku gjatë viti 2024 janë kryer këto punë:

- Kemi bërë shkresë Zyrës së Prokurimit për shpalljen e tenderëve të ndryshëm dhe kemi përgatitur të gjitha paramasat dhe parallogaritë për shpalljen e tenderëve;

- Kemi bërë pagesen e kujdestarive për 11 muaj të vitit 2024;
- Ka vazhduar participimi i pagesave në të gjitha repartet e QKMF-së, ku në këtë vit deri me datën 31.12.2024 janë inkasuar (grumbulluar) 76459.7€ për shërbimet e kryera;
- Kemi dhënë informacione të shumta për insitucione të ndryshme.

Njësia për Resurse Humane ka kryer këto aktivitete gjatë këtij viti:

- Procesimi i dokumentacionit për pranimin e stafit të ri në organizatën tonë QKMF-Viti;
- kompletimi i dosjeve;
- leshimi i aktvendimeve;
- protokollimi i dokumentacionit;
- Pushimet pa pagesë (vjetore, mjekësore) dhe kërkesa të ndryshme;
- Në Zyrën për çeshtje Juridike bëhet edhe rexhistrimi në librin për ardhje dhe shkuarje të punëtorëve.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Ka vazhduar edukimi i vazhdueshëm profesional nga ana e mjekëve dhe infermierëve sipas planifikimit të temave profesionale që janë dërguar më parë për akreditim në Odën e Mjekëve dhe Infermierëve (OMK dhe OIK).

- Nga mjekët janë mbajtur 12 ligjërata;
- Nga Infermierët janë mbajtur 12 ligjërata;
- Janë mbajtur trajnime për urgjencat shëndetësore me ekipën e paramedikëve me KFOR-in, 2 trajnime me nga 25 pjesmarrës;
- Janë mbajtur trajnime për shëndetin reprodutiv në bashkëpunim me MSH dhe UNFPA, 3 trajnime;
- Janë mbajtur trajnime për komunikimin interpersonal në bashkëpunim me MSh, Unicef dhe Amc, 75 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për EKG në bashkëpunim me Asociacionin e Mjekarve Familjarë, 9 grupe;
- Trajnimi për EKG me KFOR, 50 të trajnuar;
- Trajnime për vaksinimin, 3 grupe;
- Trajnimi për vaksinat e reja, 8 grupe;
- Trajnimi për Burnout Syndromen, 80 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për dhunën në familje, MSH, UNFPA, AMC, 9 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për raportimin e sëmundjeve kronike (masovike) jongjitëse, 13 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për vizita shtëpiake, 7 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për "klasat për nëna" dhe "kujdesi në grup", 8 punëtorë të trajnuar.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 janë realizuar këto aktivitete:

- Me 9 janar në QKMF - Viti mbahet ligjerata, "Qasja e stafit shëndetësorë ndaj pacienteve që janë objekt i dhunës në baza gjinore";
- Me 25 janar në QKM-Viti mbahet ligjerata "Astma Bronkiale";
- Me 1 shkurt QKM-Viti shënon javën e kancerit të mitrës;
- Me 8 shkurt në QKMF-Viti mbahet ligjerata: "Trajtimi i HTA-së në shtatzani";
- Me 22 shkurt në QKMF-Viti mbahet ligjerata "Parimet bazë të interpretimit të EKG-së";
- Me 4 mars QKMF-Viti shënohet "Dita Botërore e Obezitetit";
- Me 6 mars është mbajtur trajnimi "Përdorimi i instrumentit GMCD në identifikimin në fëmijërinë e

- hershme”;
- Me 20 mars QKMF -Viti ka shënuar “Ditën Botërore të Shëndetit Oral”;
- Me 21 mars shënohet Dita Botërore e Sindromit Doën”;
- Me 24 mars është shënuar “Dita botërore e Tuberkulozit”;
- Me 26 mars në QKMF-Viti mbahet ligjerata “Migrena”;
- Me 7 prill Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ka shënuar “Ditën Botërore të Shëndetit”;
- Me 9 prill në QKMF-Viti mbahet ligjerata “Reanimimi Kardiopulmunar”;
- Me 15 prill është prezantuar auditi klinik “përdorimi i antibiotikëve në infeksionet e traktit respirator”;
- Me 17 prill shënohet Dita Botërore e të Drejtave të Pacientit;
- Me 26 prill është shënuar “java e imunizimit” në Viti;
- Me 12 maj shënohet Dita Ndërkombëtare e Infermierit në Viti;
- Me 11 maj në QKMF-Viti mbahet ligjerata “infarkti akut i miokardit”;
- Me 17 maj është shënuar Dita Botërore e Hipertensionit dhe Dita Botërore e Mjekut Familjar;
- Me 24 maj është shënuar “java e ndërgjegjësimit për shëndetin mendor”;
- Me 31 maj është shënuar Dita Botërore Kundër Duhanit;
- Me 14 qershor është shënuar Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut me moton “çdo dhurues gjaku është një hero “; kurse me 02.07.2024 është mbajtur aktiviteti për dhurimin e gjakut;
- Është shënuar java e gjdhënies me moton “Ta mbështesim gjdhënien”, nga 1-7 gusht 2024;
- Është mbajtur trajnimi njëditor nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve me temën “Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve”;
- Me 27.09.2024 është shënuar Dita Botërore e Zemrës;
- Me 01.10.2024 është shënuar Dita Botërore e të Moshuarve;
- Me 01.10.2024 ka filluar aktiviteti i parë për Muajin Rozë, marsh i çiklistave;
